

SHKENCAT NATYRORE

PËR KLASËN E PARË

Viti shkollor 2022/2023

Shkencat natyrore për klasën e parë

Viti shkollor 2022/2023

Autore:
Nela Slezenkova Nikovska
Sonja Kirkovska

Recensentë:
Fadil Ajredini
Nada Jadrovska
Ordanka Mickova

Botues:
Ministria e Arsimit dhe Shkencës e Republikës së Maqedonisë së Veriut
Rr. "Shën. Kirili dhe Metodi" nr. 54, 1000 Shkup

Ilustrimet: Makedonka Toshevski

Titulli i origjinalit:
Природни науки за прво одделение
Нела Слезенкова Никовска
Соња Кирковска

Redaktor: Refail Sulejmani

Përkthyer nga gjuha maqedonase: Dalibor Sandev

Redaktor profesional i botimit në gjuhën shqipe: Mersim Fejza

Lektorë: Arbresha Kllokoci, Refail Sulejmani

Rregullimi grafik dhe teknik: Magdalena Avramovska, Evgenija Pavlova – ARS STUDIO

Shtypi: Evropa 92 – Koçan

Tirazhi: 6663

Vendi dhe viti i botimit: Shkup, 2022

Me vendim për miratimin e tekstit mësimor për lëndën Shkenca natyrore për klasën e parë nr. 26-525/1 të datës 18.08.2022 i miratuar nga Komisioni kombëtar i teksteve mësimore.

CIP - Каталогизација во публикација
Национална и универзитетска библиотека "Св. Климент Охридски", Скопје

373.3.016:5(075.2)=18

SLEZENKOVA Nikovska, Nela
Shkencat natyrore për klasën e parë : viti shkollor 2022/2023 / autore Nela Slezenkova Nikovska, Sonja Kirkovska ; [Ilustrimet Makedonka Toshevski ; përkthyer nga gjuha maqedonase Dalibor Sandev]. - Shkup : Ministria për arsim dhe shkencë e Republikës së Maqedonisë së Veriut,
2022. - 117 стр. : илустр. ; 26 см

Превод на делото: Природни науки за прво одделение / Нела Слезенкова Никовска, Соња Кирковска. - Содржи и: Shtojca

ISBN 978-608-273-173-5

1. Kirkovska, Sonja [автор]

COBISS.MK-ID 58728453

SHKENCAT NATYRORE

1



Shkup, 2022

PERMBAJTJEN

TEMA 1

NJERIU DHE TRUPI I NJERIUT 11

Fëmijët dhe të rriturit 12

SHQISA DHE NDJENJAT 24

KUJDESI PËR SHËNDETIN 13

Ushqehem në mënyrë të rregullt dhe të shëndetshme 13

Nevoja për pushim dhe aktivitet fizik për ruajtjen e shëndetit 14

Nevoja për pushim dhe aktivitet fizik për ruajtjen e shëndetit 15

Mbajtja e higjienës personale 18

Për të gene I shëndetshëm dhe I pastër, kujdesem për trupin tim 20

Veshje të pastra dhe të papastra 21

Për shëendetin tim janë të rëndësishme higjiena personale dhe veshja e pastër 23



TEMA 2

QENIET E GJALLA	**25**
BIMËT	**27**
Kafshë ose bimë?	27
Pjesët e bimës	28
Nga fara deri te bima	29
Çka nevojitet që bimët të rriten?	30
Kundesi ndaj bimëve	31
KAFSHËT	**32**
Llojet e kafshëve	32
Grupimi I kafshëve	33
Kafshët shtëpiake dhe kafshët e egra	34
Habitate të ndryshme	35
VEÇORITË E QENIEVE TË GJALLA	**36**
Mënyra e jetës së bimëve, të kafçhëve dhe të njeriut	36
Si ndryshohen qeniet e gjalla me kallmin e kohës?	37
Nevojat elementare të qenieve të gjalla	38
Cfarë e nevojitet qenieve të gjalla për jetë dhe cfarë nuk u nevojitet?	39
Karakteristikat e qenieve të gjalla	40
Fazat e ndryshme të jetës së njeriut	42
DALLIMET NDËRMJET QENIEVE TË GJALLA	**44**



TEMA 3



Materialitet 47

LLOJET E MATERIALEVE 49

Materialitet në mjedis 49

Prej çfarë është bërë? 52

VETITË E MATERIALEVE 53

Zbulimi i vetive të materialeve 54

Vetia e përbashkët te materialet e ndryshme 56

Dallimi midis vetive të kundërta të materialeve 58

Grupimi i materialeve sipas vetive të tyre 59

PËRDORIMI I MATERIALEVE 60

Çdo material ka përdorimin e caktuar 60



TEMA 4

FORCA DHE LËVIZJA 63

LËVIZJA 65

Llojet e ndryshme të lëvizjes 65

Mënyra e lëvizjes 66

Lëvizja e gjësendeve 67

FORCAT 68

Shtyrja dhe tërheqja 68

Përdorimi i forcës 69

Forcat tërheqëse dhe forcat 70

magnetike refuzuese 71

Veprimi i ndryshëm magnetik 72

Veprimi i ndryshëm magnetik 73



TEMA 5

TINGULLI	**75**
TINGULLI DHE BURIMET E TINGULLIT	**77**
Njoha e tingujve të ndryshëm dhe burimet e tyre	77
Burimet e ndryshme të tingullit nga mjedisi	79
Me çka dëgjojmë tinguj?	80
Llojet e tingujve	81
Lëvizja e sendeve krijon tingull	82
TINGUJT MUZIKOR	**83**
Tinguj prej instrumenteve të ndryshme muzikore	83
Si e krijojnë tingullin instrumentet muzikore?	85
Burimet e tingullit	86
PËRCJELLJA E TINGULLIT	**87**
Tingulli shpërndahet	87
Intensiteti I tingullit	88
Eksperimente shtesë për tingullin	89

Lapsushët, miqtë tuaj të rinj, do t'ju udhëheqin nëpër përmbajtjeve të librit mësimor të Shkencave natyrore.

E-rëndësishme!

Vizato/Shkruaj!

Rretho!

Lidh!

Ngjyros!

Vëzhgo!

Mendo dhe përgjigju:

Përshkruaj!

Hulumto!

Prej!

Ngjit!

Qëllo!

Shlyej!

I dashur nxënës i klasës së parë,

Përpara teje është libri mësimor i lëndës së **Shkencave natyrore.**
Ky libër mësimor do të ndihmojë që të zbulosh shumë gjëra tërheqëse për:

-njeriun dhe trupin e njeriut;
-qeniet e gjalla;
- materialet;;
- forcat dhe lëvizjen dhe
-tingullin.

Sa më shumë i zbulon fshehtësitë e **natyrës** ,aq, më shumë do ta dëshirosh atë dhe të kujdesesh për të. Vëzhgo me kujdes fotografitë, vizato, ngjyros, shto, hulumto, përgjiglu pyetjeve...
Nëse diçka nuk ke të qartë pyete shokun,mësuesin ose dike më të rritur nga familja jote.
Shpresojmë se shoqërimi me këtë libër mësimor të jetë një udhëtim tërheqës dhe emocionues për ty.

Falënderim të veçantë për prof. të grupit klasor Biljana Lazareska dhe prof. të grupit klasor, Biljana Stojanovska, të cilat dhanë kontribut të veçantë në përgatitjen e tekstit.

Nga autorët

Tem

1

NJERIU DHE TRUPI I NJERIUT

MUNDEMI SË BASHKU



KUJDESI PËR SHËNDETIN

Çka është shërbyer në pjatën time?

PEMË

USHIM KOKROR

PERIME

MISH DHE PRODHIME TË QUMËSHTIT

Shfrytëzoje shtojcën nr.2

USHQEHEM NË MËNYRË TË RREGULLT DHE TË SHËNDETSHME

VIZATO çfarë do të hash për çdo vakt!

KRIJO NJË MENY DITORE ME USHQIM TË SHËNDETSHËM

1. MËNGJES

2. MEZE

3. DREKË

4. MEZE

5. DARKË

Fëmijët duhet të ushqehen në mënyrë të rregullt dhe të shëndetshme. Gjatë ditës duhet të kenë pesë vakte: mëngjes, drekë, darkë dhe dy meze.

NEVOJA PËR TË PUSHUAR DHE AKTIVITETI FIZIK PËR RUAJTJEN E SHËNDETIT



FLI MJAFTUESHËM!

LËVIZ QË TË JESH I SHËNDETSHËM!



Shiko mirë otografinë
Mendo dhe
Përgjigju:
Cilat aktivitete i bën ti çdo ditë për të lëvizur trupin tënd?

AKTIVITETI FIZIK

- Aktivitet e përditshme
- Sporti
- Ushqimet
- Loja

Në piramiden e aktivitetve:

1. **VIZATO** aktivitetet fizike që bën çdo ditë, shpesh, ndonjëherë si dhe pasivitet fizik (shikimi i televizionit, lojërat kompjuterike)

2. **PSE JANË TË RËNDËSISHËM PËR NE** aktiviteti fizik dhe pushimi?



KUJDESI PËR HIGJIENËN PERSONALE

BANJË

LARJA E FLOKËVE

LARJA E DHËMBËVE

LARJA E DUARVE

LARJA E FYTYRËS

PRERJA E THONJËEVE

Shiko fotografitë, **mendo** e kush do të kursejë më shumë ujë gjatë mbajtjes së higjienës personale dhe **pastaj** **ngjyros** katrorin pranëfotografisëmengjyrëtë **gjelbër** (nëse konsideron se fotografia tregon kursimin e ujit) ose **me ngjyrë** tëkuqe (nëse konsideronse fotografia nuk tregon kursimin e ujit)!

PËR TË QENË I SHËNDETSHËM DHE I PASTËR, KUJDESEM PËR TRUPIN TIM!

SHPJEGO dhe **VIZATO** procedurat e higjienës personale!

VESHJA E PASTËR DHE E PAPASTËR

VESHJA jonë është një pjesë prej neve, ne duhet ta mirëmbajmë dhe gjithmonë të jetë e pastër dhe e hekorusur.

JANA DHE BENI KANË VESHJE TË PAPASTËR

EJANI T'I BËJMË TË LUMTUR, T'I VIZATOJME ME VESHJE TË PASTRA!



KLASIFIKO!

ZHVENDOS RROBAT E PASTRA NË DOLLAP DHE RROBAT E PAPASTRA NË MAKINËN RROBALARËSE!

Shfrytëzoje Shtojcën nr.3!

HIGJIENA PERSONALE DHE RROBAT E PASTRA JANË TË RËNDËSISHME PËR SHËNDETIN TIM

1. Ç' është higiena **PERSONALE?**
2. Çfarë janë **ROBAT E PASTRA**
3. Si **KUJDESESH** për higienën personale?
4. Pse duhet të **kujdesemi** çdo ditë për trupin dhe rrobat tona?
5. Pse higjiena personale dhe rrobat e pastra janë të rëndësishme për **SHËNDETIN** e njeriut?

DËGJO, MENDO DHE PËRGJIGJU!

Në kornizën harto një **POSTËR** me temë: Higjiena **PERSONALE** dhe rrobat e **PASTRA** janë të rëndësishme për shëndetin tim?

SHQISAT DHE NDJENJAT

ME SY TË MBYLLUR OSE KËMBË APO DORË TË LIDHUR, NJË GJËSEND TË CAKTUAR NGA NJËRI SKAJ I KLASËS ÇOJE NË SKAJIN TJETËR TË KLASËS! SHOKËT OSE SHOQET MUND TË NDIHMOJNË DUKE TREGUAR KAHJEN E LËVIZJES.

TEMA

2

QENIET E GJALLA

REZULTATET E MËSIMIT

NXËNËSI/ NXËNËSJA DO TË AFTËSOHET:

TI IDENTIFIKOJË njerëzit, kafshët dhe bimët si qenie të gjalla dhe

T'I EMËRTOJË dhe **PËRSHKRUAJË**

dallimet kryesore ndërmjet tyre

T'I SHPJEGOJË

karakteristikat themelore të qenieve të gjalla (bimët, kafshët dhe njerëzit)



BIMËT

KAFSHË OSE BIMË?

GJEJE ÇFARË JAM! VENDOS NJË SHIGJETË, NË TË MAJTË, NËSE JAM KAFSHË OSE NË TË DJATHTË NËSE JAM BIMË!

PËRSHKRUAJ qeniet e gjalla dhe përcakto vendbanimet e tyre!

Kafshët dhe bimët janë **QENIE TË GJALLA.**

QENIET E GJALLA

jetojnë në vendbanime të ndryshme: livadh, pyll, ujë, shkretëtirë, rajone polare, ….

Vizato një kafshë që jeton në ujë!

Vizato një bimë që rritet në pyll!

PJESËT E BIMËS

ZBULO PJESËT E BIMËS DHE SHKRUAJ FJALËN!
PASTAJ NGJYROS BIMËN!



EKZISTOJNË BIMË ME PJESË TË NDRYSHME.

Gjethi
Trungu
Rrënja



Fruti
Lulja
Gjethi
Trungu
Rrënja

VIZATO PJËSËT E DHËNA TË BIMËS!
RRËNJA FRUTI GJETHI TRUNGU

Rrënja	Fruti	Gjethi	Trungu

NGA FARA TE BIMA

FARA MUNDËSON RRITJEN RRITJEN E BIMËVE TË REJA DHE TË MBIJNË ATO SI DHE KULTIVIMIN E FRUTAVE TË REJA

FARAT I GJEJMË TE FRUTAT. FRUTAT DHE FARAT MUND TË JENË ME FORMA DHE MADHËSI TË NDRYSHME.

MENDO DHE PËRGJIGJU:

- Ku ndodhet fara?
- Çfarë mundëson fara?
- A janë farat e njëjta te të gjitha bimët?

HULUMTO!

- Bëj model të një bime me materiale të ndryshme (plastelinë, pecete letre,tuba) dhe vëzhgo pjesët e bimës.

Në rrethin **SHKRUAJ** numrat që tregojnë renditjen e rritjes dhe zhvillimin e kungullit!



ÇFARË NEVOJITET QË BIMËT TË RRITEN?

Shiko fotografinë! **PËRSHKRUAJ** rritjen dhe zhvillimin e bimës!
Çfarë i duhet një bime për rritje dhe zhvillim?

BIMËT janë qenie të gjalla. Jeta e bimëve mund të fillojë nga fara. Fara do të rritet nëse ka mjaft ujë, ajër, dritë dhe nxehtësi.



Të rikujtohemi!
LIDH termat me pjesët e bimës!



MENDO DHE PËRGJIGJU:

* Pse bimët janë qenie të gjalla?
* Krahaso si duket fara dhe si duket bima e rritur.
* Çfarë do të ndodhë me bimën nëse nuk ka ujë të mjaftueshëm?

HULUMTO!

* Mbillni një bimë në klasë dhe vëzhgojeni atë!
* Çdo të premte shënoni ndryshimet në librin e vëzhgimeve (Shtojca nr.4)!

KUJDESI NDAJ BIMVË

PËRSHKRUAJ dallimin midis bimëve që sheh në fotografitë!



VIZATO ☺ pranë figurës që paraqet kujdesin ndaj bimëve ose pranë ☹ figurës që paraqet kujdesin ndaj bimëve!

Si duhet të kujdesemi për bimët?

MENDO DHE PËRGJIGJU:

- ★ Vëzhgo një pemë, lule, bar dhe emërto pjesët e tyre!
- ★ Ku rriten llojet e ndryshme të pemëve?
- ★ Ku rriten llojet e ndryshme të perimeve?

HULUMTO!

- ★ Ku rriten bimët? Si usqehen? A kanë nevojë për dritë që të rriten?

KAFSHËT

LLOJET E KAFSHËVE

NGJYROS emrat e kafshëve që i takon në mjedisin tënd!

PËLLUMBI	HARABELI	DERRI	QENI	ARIU	DHIA
LOPA	DHELPRA	PULA	MACJA	PAPAGALLI	LEJLEKU

KAFSHËT SHTËPIAKE

KAFSHËT PËRKËDHELËSE

KAFSHËT E EGRA

Shfrytëzoje shtojcën nr.5 dhe **NGJIT!**

Zgjidh dhe **PËRSHKRUAJ** një kafsgë, me tri fjalë. Si LëVIZ? Me çfarë ushqehet? Ku jeton?

MENDO DHE PËRGJIGJU:

- Ku jetojnë kafshët e egra? Si vijnë deri te ushqimi?
- Ku jetojnë kafshët shtëpiake?
- Cilën kafshë përkëdhelëse do të dëshiroje ta kishe? Nëse tashmë ke një kafshë në shtëpi, shpjego se si kujdesesh për të!

HULUMTO!

- Kush kujdeset për kafshët endacake, si t'i ndihmojmë që të jenë nën përkujdesje dhe të sigurt?

GRUPIMI I KAFSHËVE

KAFSHËT janë qenie të gjalla. Ato kanë mënyrën e ndryshme të ushqimit, mënyrën e ndryshme të lëvizjes, vendbanimet e ndryshme...

SIPAS MËNYRËS SË USHQIMIT, KAFSHËT NDAHEN NË TRI GRUPE;

BARNGRËNËS | **GJITHÇKANGRËNËS** | **MISHNGRËNËS**



Shfrytëzoje shtojcën nr.6! Mendo dhe **NGJIT!**

Sipas mënyrës së lëvizjes, kafshët ndahen në disa grupe.

Është dhënë një shembull për secilin grup.
Ti **VIZATO** edhe nga një kafshë tjetër!

EC /VRAPON	KËRCEN	ZVARRITET	FLUTURON	NOTON/ZVARRITET

KAFSHËT SHTËPIAKE DHE TË EGRA

KAFSHËT mund të ndahen edhe sipas asaj se kush kujdeset për to, kush i ushqen dhe ku ato jetojnë. Për **KAFSHËT SHTËPIAKE** kujdeset njeriu. Ai i ushqen, kujdeset për shëndetin e tyre dhe u siguron strehim. Nga disa kafshë shtëpiake, njeriu merr qumësht, vezë, pupla, lëkurë, lesh dhe disa prej tyre i ndihmojnë njeriut gjatë punës. **KAFSHËT E EGRA** kujdesen për vetveten, vetë gjejnë ushqim dhe vetë sigurojnë strehim.

QËLLO
gjëegjëzat!

CAKTO KAFSHËT E MËPOSHTME DHE PËRGJIGJU NËSE JANË SHTËPIAKE APO TË EGRA! PSE?

Ai ka veshë të mëdhenj dhe i pëlqen të kërcejë edhe në dimër. Ai është shumë i shpejtë dhe karotat ai i ha vetë.. _ _ _ _ _

Asaj i pëlqen të shkojë në livadh,dhe zilja e qafës të çon.Ajo jep qumësht dhe quhet _ _ _ _ _ .

Rri në pyll e në lëndinë
Ecën porsi balerinë
Ka dy brirë me degë në kokë Kur vrapon nuk e kap dot . _ _ _ _

GJEJ
kafshët me ndihmën e shkronjave të para të fotografive.

LOPA

K L
_ _ _



LU_
_ _ _

Q N
_ _ _ _

MENDO DHE PËRGJIGJU:

- Si vijnë deri te ushqimi kafshët shtëpiake?
- Si vijnë deri te ushqimi kafshët e egra?
- Çfarë përfitimesh ka njeriut nga kafshët shtëpiake?

AKTIVITETET SHTESË:

- Krijo nga një model kafshe shtëpiake dhe të egër dhe shkruaj një tregim!
- Imito tingujt dhe lëvizjet e kafshëve!

HULUMTO!

- Çka përfiton njeriu nga dhentë, dhe çka nga pulat?



VENDBANIMET E NDRYSHME

VIZATO kafshët që i përkasin VENDBANIMIT të duhur!Pastaj **NGJYROS** figurën!

VENDBANIME TË TJERA NËPËR BOTË

VENDBANIMI është vend ku jetojne lloje të veçanta të qenieve të gjalla dhe i kanë kushtet e nevojshme të jetesës.

SHKRETËTIRA

VISET POLARE

SAVANA

KARAKTERISTIKAT E QENIEVE TË GJALLA

MËNYRA E JETËS SË BIMËVE, KAFSHËVE DHE NJERIUT

MENDO DHE PËRGJIGJU:

- Çfarë vëren në figurën 1, pse janë tëlumtur prindërit?
- Çka ndodh në figurat 2 dhe 3?

1.

2.

3.



QENIET E GJALLA

NJERI

KAFSHË



BIMË

Qeniet e gjalla **LINDIN, PRITEN, RIPRODHOHEN, PLAKEN** dhe **PUSHOJNË SË JETUARI!**

HULUMTO!

★KRIJO një kronologij - shirit kohor të fotografive tuaja nga foshnja deri te nxënësi! Shpjego si dukesh në secilën fotografi ti! Cilat ndryshime i vëren nga koha kur ishe foshnjë deri tani që je nxënës?

VIZATO ATË QË MUNGON!

SI NDRYSHOHEN QENIET E GJALLA ME KALIMIN E KOHËS

BIMË 		
NJERI		
ZOG 		

Mendo dhe trego shembuj të tjerë të qenieve të gjalla dhe shpjego si ndryshohen ato me kalimin e kohës!

NEVOJAT ELEMTARE TË QENIEVE TË GJALLA

MENDO DHE PËRGJIGJU

★ Çka ka ndodhur me bimën në fotografi? Pse duket kështu?

★ Çka bën qeni në fotografi?

Qenieve të gjalla u nevoitet **USHQIM,** për energji dhe rritje. Bimët e krijojnë vetë ushqimin e tyre. Kafshët nuk krijojnë ushqim, ato hanë bimë dha kafshë të tjera.

NEVOJAT ELEMENTARE TË QENIEVE TË GJALLA PËR TË MBIJETUAR

USHQIMI

AJRI

UJI

DIELLI

VENDBANIMI

HULUMTO!

★ Sa gota ujë pini në ditë? Flisni me familjen tuaj për rëndësinë e ujit! Rezultatet e fituara prezantojini me video të regjistruar ose me vizatim!

Pjesa më e madhe e trupit të qenieve të gjalla përbëhet nga **UJI.** Uji i pastër dhe i freskët është i nevojshëm për pije, banjë, gatim, larje rrobash, ujitje të bimëve.

PREJ DHE NGJIT

ÇFARË U NEVOJITET QENIEVE TË GJALLA PËR JETË DHE ÇFARË NUK U NEVOJITET

TË NEVOJSHME PËR JETË

TË PANEVOJSHME PËR JETË

Shfrytëzoje shtojcën nr.7 dhe ngjit!

KARAKTERISTIKAT E QENIEVE TË GJALLA

Sara dhe Denisi erdhën në fshat për ti vizituar gjyshen dhe gjyshin e tyre. Gjyshja dhe gjyshi i prisnin me padurim.

– Denis, Sara nipërit e mi, sa janë rritur!- bërtitën të dy njëzëri. Papritmas me vrap arriti edhe qeni, Lusi.

– Gjyshe, a është ky këlyshi i vitit të kaluar?

– Po mbesë, tani është rritur!

– Lusi ka një surprizë për ju, por ne do ta lëmë për nesër!

– Ejani, hyni brenda nipërit e mi. Keni udhëtuar gjatë, duhet të hani darkë.

Në shtëpi gjithçka është e njëtë: furra ku gjyshja pjek, tryeza e vjetër, lugët, pirunët, pjata janë të njëjtat..

Në fshat agoi një mëngjes i bukur

– Sara, zgjohu! - bërtiti Denisi.

Pas larjes së dhëmbëve dhe ngrënies së mlngjesit, ata tashmë ishin gati për aksion. .

– Denis, unë do të marr aparatin fotografik. Dëshiroj të bëj fotografi nga ferma dhe t'ua tregoj shokëve dhe shoqeve.

– Ide e mirë – u pajtua Denisi

Këto janë fotografitë që i bënë të dy së bashku.

SHIKONI fotografitë e bëra nga Sara dhe Denisi dhe **BISEDONI** për secilën prej tyre!









LIDH!

Prindi me këlyshin
e tij.

HULUMTO!!

Me çfarë ushqehen kafshët
dhe të vegjlit e tyre?

LOPA

EDHI

DELJA

VIÇI

PULA



MËZI

QENI

QENGJI

PELA

KËLYSHI

DHIA

ZOGU

FAZAT E NDRYSHME TË JETËS SË NJERIUT

GJATË JETËS SË TIJ, NJERIU KALON NËPËR DISA FAZA, SI NË VIJIM: FOSHNJË, FËMIJË, VAJZË/DJALË, I/E RRITUR DHE PLAK/PLAKË



NË SECILËN FAZË NDODHEN NDRYSHIME FIZIKE TE NJERIU.



HULUMTO

★Hulumto për anëtarët e familjes tënde!

★ Kush çfarë mund të bëjë dhe të punojë? Pyet babain ose nënën tëndë, gjyshin ose gjyshen kur ata kanë mësuar të ngasin biçikletë ose makinë!

Bëj kubin si në figurën (Shtojca nr.8) dhe më pas luaj një lojë me shokun tënd. E rrokullisni kubin; fotografinë që e keni fituar me rrokullisjen, e përshkruani dhe u prgjigjeni pyetjeve vijuese:

★ Cila fazë e ciklit jetësor të njeriut është?

★ Çfarë mund të bëjë personi në atë fazë?

PRIT, RADHIT, NGJIT, SHPJEGO
për çdo fazë të jetesë së njeriut!

Shfrytëzohe shtojcën nr.9 dhe ngjit!

FOSHNJË	FËMIJË	VAJZË	E RRITUR	PLAKË

FOSHNJË	FËMIJË	DJALË	I RRITUR	PLAK

DALLIMET MIDIS QENIEVE TË GJALLA DHE JO TË GJALLA



MENDO DHE PËRGJIGJU:

★ Ç'është e gjallë dhe çfrarë nuk është e gjallë në këtë fotografi?

★ Numëro dhe shpjego!

KRAHASO DHE SQARO!

★ Cili është dallimi ndërmjet njeriut dhe gurit?

★ Cili është dallimi ndërmjet kafshëve dhe diellit?

BIMËT

KAFSHËT

NJERIU

JO TË GJALLË
çdoherë mbetet e njëjtë e pandryshueshme

JANË TË LIDHURA MES VETI, POR EDHE DALLOHEN

GJALLË
është ajo që merr frymë, që rritet që ushqehet,që lëvizet dhe që shumohet.

AJRI

UJI

DIELLI

GURI

HULUMTO!

Së bashku me mësuesin/en dilni në oborrin e shkollës dhe shikoni përreth!
Gjej dhe vizato një krijesë të gjallë dhe diçka jo të gjallë!



NGJYROS RRATHËT PRANË FOTOGRAFIVE ME NGJYRË TË KUQE NËSE ËSHTË JO E GJALLË, ME NGJYRË TË GJELBËR, NËSE ËSHTË E GJALLË!

Zgjidh dy fotografi sipas dëshirës, njërën fotografi për qenie të gjalla dhe tjetrën për qenie jo të gjalla dhe përshkruaji ato!













TEMA

3

MATERIALET

REZULTATET E MËSIMIT

NXËNËSI/ NXËNËSJA DO TË AFTËSOHET:

1. **T'I NJOHË** llojet e ndryshme të mterialeve ;
2. **T'I DALLOJË** vetitë e materialeve dhe t'i **t'i KLASIFIKOJË** materialetsipas vetive të dhëna;
3. **TA LIDHË** zbatimin e materialeve me vetitë e tyre



LLOJET E MATERIALEVE

MATERIALET NË MJEDIS

Në jetën tonë të përditshme përdorim gjësende te ndryshme. A keni menduar ndonjëherë se prej çfarë janë bërë? Kur shikojmë gjësende përreth nesh, ato janë shumë të ndryshme nga njëra-tjetra. Kur tëvini në shkollë, gjatë rrugës shikoni përreth, çfarë gjësende do të shihni ?

VIZATO
Gjësendet që i ke parë dhe i ke vërejtur gjatë rrugës nga shtëpia për në shollë!

EMËRTO
gjësendet në fotografitë! Cili gjësend prej çfarë materiali është bërë ?



GJËSENDET JANË BËRË NGA MATERIALE.

LLOJET E MATEREIALEVE

LETËR	TEKSTIL	DRU
GUR	METAL 	PLASTIKË
QERAMIKË	QELQ	GOMË 

JAM BËRË PREJ:



PLOTËSO FJALITË:

 Është bërë prej _ _ _ _ _ _.

Është bërë prej _ _ _ _ _.

Është bërë prej _ _ _ _ _ _ _ _.

Është bërë prej _ _ _ _ _ _ _ _ _.

Është bërë prej _ _ _ _ _.

LOJË

Me mësuesin/mësuesen dilni në oborrin e shkollës! Luajni lojën **„PREK DIÇKA PREJ METALI; PREJ DRURI DHE PREJ PLASTIKE" !**

HULUMTO!

★ Prej cilave materiale janë bërë këpucët që i mbath në stinë të ndryshme të vitit (verë, vjeshtë, dimër dhe pranverë) ?

Shëno me X atë që është ndyshe me ngjyrë **të kuqe** në vargjet e dhëna me gjësende!

PLASTIKË			
DRU			
METAL			
GOMË			
TEKSTIL			
QERAMIKË			
QELQ			

PREJ ÇFARË ËSHTË BËRË?

LIDH!

GUR

TEKSTIL

LETËR

PLASTIKË

QELQ

DRU

GOMË

METAL

QERAMIKË

HULUMTO!

★ Prej cilave materiale është bërë automjeti?

★ Mendo pse është bërë nga ai materail?

VETITË E MATERIALEVE

ZBULIMI I VETIVE TË MATERIALEVE

AKRIVITETET HULUMTUESE!

Në një strajcë gjenden gjësende të ndryshme: gur, gjësende prej druri (lodër), gogla qelqi, shpuzë, copë pëlhure, llastik për flokë, gotë plastike, magnet. Nxënësit tërheqin gjësende nga strajca. Pastaj, me ndihmëri e shqisave të tyre i zbulojnë vetitë e materialeve.

MENDO DHE PËRGJIGJU:

1. Nga cili material janë bërë gjësendet?
2. Cilat veti i kanë materialet?
3. Krahaso dy gjësende të bëra nga material i njëjtë!
4. Çka është e ngjashme dhe e ndryshme tek ato?
5. Cilat shqisa i ke përdorur për ta bërë krahasimin?



Me fjalët vijuese përshkruhen materialet në bazë të vetive të tyre:

E FORTË, E BUTË, E LËMUAR, E VRAZHDË, ELASTIKE, E REZISTENTE NDAJ UJIT, E THYESHME, E TEJDUKSHME, ME SHKËLQIM, MAGNETIKE

ZBULIMI I VETIVE TË MATERIALEVE

Unë jam karrige e fortë, e lëmuar, me shkëlqim. Jam e bërë prej druri.

Unë jam gotë e fortë, e lëmuar, me shkëlqim dhe e thyeshme. Jam e bërë prej qelqi.

Ne jemi të butë, të lëmuar, elastikë dhe rezistues ndaj ujit. Jemi të bërë prej gome.

Unë jam kapëse e fortë, e lëmuar, rezistente ndaj ujit dhe magnetike. Jam e bërë prej metali.



Mia dhe Eldari janë shokë të ngushtë. Çdo ditë luajnë bashkë lojëra të ndryshme. Sot ata luajtën lojën "Qëllo gjësendin". Ejani të bashkangjitemi në lojën e tyre! Ata përshkruajnë gjësendet pa treguar emrat e tyre. Mundohuni t'i qëlloni gjësendet e përshkruara!

Gjësendin e përdorim shipeshherë në shkollë. Është prej druri, i fortë, i lëmuar dhe i thyeshëm.

L_ _ _ _.

Gjësendin e përdorim për të pirë ujë. Është rezistues ndaj ujit, i lëmuar, i bërë prej plastike.

G_ _ _.

Janë me ngjyra të ndryshme, prej pambuku, të buta, elastike, të shkurta për verë dhe të gjata për dimër.

P_ _ _ _ _ _ _ _.

E përdorim për mëngjes, për drekë dhe për darkë. Mund të jetë prej plastika, druri ose metali. Ajo është e lëmuar dhe e fortë.

L_ _ _ .

Ngjyros rrathët në të cilët janë dhënë vetitë e materialit prej të cilit është bërë gjësendi!









VETIA E PËRBASHKËT TE MATERIALET E NDRYSHME

KUBE DRUDI

VAZO QERAMIKE

GOTË QELQI



KAPËSE METALIKE

Në fotografitë e dhëna janë paraqitur gjësendet e bëra prej materialeve të ndryshme (prej druri, qeramika, qelqi dhe metali). Vetia e përbashkët e tyre është se janë të bëra prej materialit të **FORTË.**



Në rrethin në të majtë vizato gjësende që janë të lëmuara, ndërsa në rrethin djathtas vizato gjësende që janë rezistente ndaj ujit! Në mes vizatoi gjësende që i kanë të dy vetitë !



Plotëso vargun me vizatim!

I/E VRAZHDË			
I/E BUTË			
I/E TEJDUKSHË M-ME			
I/E THYESHËM-ME			
REZISTENTE NDAJ UJIT			

DALLIMI MIDIS VETIVE TË KUNDËRTA TË MATERIALEVE

Arta dhe Maksimi janë fqinj. Ata luajnë së bashku çdo ditë në livadhin aty pranë Një ditë, derisa ata po luanin, moti u bë i vrenjtur. Filloi të bjerë shi! Çfarë duhet të veshin Arta dhe Maksimi që mos të lagen nga shiu? Çfarë duhet të veshin ata kur koha të jëtë me diell ?

ME NGJYRË TË KUQE LIDHNI MATERIALET NË FOTOGRAFITË QË KANË VETI TË KUNDËRT!

ÇIZME GOME REZISTENTE NDAJ UJIT

XHAKETË GOME REZISTENTE NDAJ UJIT

ATLETE PËLHURE REZISTENTE NDAJ UJIT

BLUZË PAMBUK U REZISTENTE NDAJ UJIT

MENDO DHE PËRGJIGJU:

★ Cilat janë vetitë e kundërta të materialeve nga të cilat janë bërë gjësendet në këto fotografi?

★ Zgjidh dy gjësende nga fotografitë e dhëna dhe shpjego vetitë e kundërta të materialeve prej të cilave janë bërë!



GRUPIMI I MATERIALEVE TË TYRE

PREJ DHE NGJIT

Grupo materialet sipas vetive të tyre!

Shfrytëzoje Shtojcën nr.10!

TË FORTA, TË LËMUARA DHE REZISTENTE NDAJ UJIT

TË BUTA, ELASTIKE DHE JO REZISTENTE NDAJ UJIT

PËRDORIMI I MATERIALEVE

ÇDO MATERIAL KA PËRDORIM TË CAKTUAR

MATERIALET dallohen mes tyre. Çdo material ka veti të caktuar. Është me rëndësi t`i njohim vetitë e materialeve që të dimë se cilin material duhet ta përdorim për të bërë ndonjë gjësend. Gjësendet mund të bëhen prej materialeve të ndryshme

Çka mund të bëjmë nga **PAMBUKU?**

Çka mund të bëjmë nga **METALI?**



Çka mund të bëjmë nga **DRURI?**

VIZATO gjësendin tënd të preferuar dhe shkruaj prej cilave materiale është bërë?

MENDO DHE PËRGJIGJU:



★ Prej cilave materiale është bërë automobili?
★ A mund të bëjmë automobil prej qeramike? Pse?

★ Sqaro pse automobili nik është bërë vetëm prej një materiali?

HULUMTO!!

★ Prej cilave materiale është bërë biçikleta?
★ Mendo pse është bërë prej tyre?

LIDHI fotografitë me materialet e shkruara në retë!



METAL

QERAMIKË

QELQ

LETËR

GOMË

PLASTIKË

GUR

TEKSTIL

DRU

Vizato dy gjësende të bëra prej druri dhe sqaro pse është përdorur ai material!



Vizato dy gjësende të bëra prej metali dhe sqaro pse është përdorur ai material!



Vizato dy gjësende të bëra prej plastike dhe sqaro pse është përdorur ai material!

Vizato dy gjësende të bëra prej gome dhe sqaro pse është përdorur ai material!

AKTIVITET

★ Punë në grupe të vogla: punimi i gjësendeve prej materialeve të dhëna dhe testimi nëse janë të përshtatshme për përdorimin e caktuar (p.sh: anije prej letre, anije prej folie alumini, ombrellë prej fije leshi, kapelë prej letre, kapak për kavanoz prej flete plastike, jastëk pambuku dhe tekstili, mbulëse që mbron nga uji e përpunuar prej qeseve të plastikës dhe gjëra të ngjashme.)

TEMA

4

FORCA DHE LËVIZJA

REZULTATET E MËSIMIT

NXËNËSI/ NXËNËSJA DO TË AFTËSOHET

T'I KRAHASOJË LËVIZJET
në trupin e tij/saj, lëvizjet e kafshëve dhe lëvizjet e sendeve;

TA NJEHË FORCËN
si shkak për lëvizje dhe ndryshimin e lëvizjes së trupave me shtyrje dhe tërheqje.

T'I ZBULOJË FORCAT MAGNETIKE
duke tërhequr trup / magnet, magnet / magnet dhe dëbim magneti / magnet.

LËVIZJET

LLOJET E NDRYSHME TELËVIZJEVE

★ Shiko figurën dhe trego cilat trupa lëvizin?

TRUPAT lëvizin në mënyra të ndryshme.

NJERËZIT lëvizin në mënyra të ndryshme, për shembull: ecje, vrapim, kërcim, rrëshqitje, lëkundje, rrotullim në rreth dhe notim.

SHPEZËT fluturojnë, kërcejnë dhe ecin, disa prej tyre edhe notojnë.

TOPI mund të rrokulliset dhe të kërcejë.

PËRGJIGJU:

★ Si do ta përshkruani lëvizjen e kafshëve në fotografi?

★ Si do të jetë lëvizja e ketrit? Parashiko!

★ Si do ta përshkruash lëvizjen e fëmijëve që luajnë me top?

HULUMTO!

★ Ndahuni në grupe dhe bëni një plan, kështu që do të hulumtoni lëvizjen e harabelave kur bënë fole, dhe të fëmijëve të cilët rrëshqasain në rrëshqitëse.

NË FILLIM, PASTAJ, NË FUND

MËNYRAT E LËVIZJES

Sqaro kush si lëviz!

RRËSHQITJA



FLUTURIMI



KËRCIMI

ECJA

NOTI

VRAPIMI

Në tabelën e mëposhtme, shkruani nga një shembull dhe diskutoni për mënyrën e lëvizjes!

i/e shpejtë		i ngadalshëm / e ngadalshme	
më i/e shpejtë		më i ngadalshëm / më e ngadalshme	
shumë i/e shpejtë		shumë i ngadalshëm / shumë e ngadalshme	

LËVIZJA E SENDEVE

Si lëvizen sendet?

BIÇIKLETA

TRENI



AEROPLANI



AEROPLANI I LETRËS



BALONA

VARKA

AUTOMOBILI

ANIJA

Ndryshimi në **LËVIZJE** është rezultati i **FORCËS.**

MENDO DHE PËRGJIGJU:

- Cilat lodra mund të lëvizin?
- Cilat lodra mund të kurdisen?
- Cilat lodra kanë motor që i lëviz?
- Cilat lodra duhet t`i shtyjmë dhe t`i tërheqim që të lëvizin?

BËNI NJË ORIGAMË - aeroplan letre dhe vemje dhe përpiqu që t'i lëvizësh ato.

Shfrytëzoje shtojcën nr.11 !

PLOTËSO DHE PËRGJIGJU!

1. Treni, motoskafi, aeroplani, lëvizin më shpejt sepse kanë

.....

2. Biçikletën dhe automobilin lodër mund t`i lëvizim me

.....

3. Era mund t`i lëvizë

.....

4. Kush lëvizet më ngadalë?

.....

FORCAT

SHTYTJE DHE TËRHEQJE

SHTYTJE ose **TËRHEQJE** e një sendi quhet forcë. Trupat **LËVIZIN** kur i **SHTYJMË** ose kur i **TËRHEQIM.**

Djali e e **SHTYEN** karrocën

Vajza e **TËRHEQ** valixhen

Ngjyros katrorin me ngjyrë **PORTOKALLI** nëse shtyn ose me ngjyrë të **GJELBËR** nëse tërheq!

PËRDORIMI I FORCËS

FORCËN e krijojmë duke shtytur ose tërhequr.

FORCA PARAQITET GJITHMONË KUR DY TRUPA SHTYHEN OSE TËRHIQEN.

SI E SHKULI GJYSHI PANXHARSHEQERIN ?

panxharsheqeri nuk lëvizi. Ai thirri gjyshen për ta ndihmuar. Gjyshi e kapi panxharsheqerin, pastaj gjyshja e kapi gjyshin dhe së bashku filluan të tërheqin. Por, panxharsheqeri nuk lëvizi.

Meqenëse ishin të moshuar dhe nuk kishin forcë të mjaftueshme, ata thirrën mbesën, pastaj qenin,macen dhe në fund miun. Të gjitë së bashku e tërhoqën fort dhe papritmas panxharsheqeri i madh u shkul.

Përrallë popullore

Gjyshërit e mi jetonin në një fermë. Gjyshi mbolli panxharsheqer në kopsht. Ai kujdesej për të çdo ditë. Kështu panxharsheqeri u rrit shumë. Një ditë gjyshi donte ta shkulte nga rrënja, kapi panxharsheqerin dhe filloi ta tërhiqte, duke lëvizur majtas dhe djathtas, por

MENDO DHE PËRGJIGJU:

- ★ Miu i vogël a ishte kaq shumë i fuqishëm apo forca ishte e të gjithëve së bashku?
- ★ Çfarë force përdorën ata?

AKTIVITET

- ★ Lëviz nëpër klasë disa objekte!
- ★ Emërto se çfarë force ke përdorur, forcën e shtytjes apo të tërheqjes?
- ★ Vizato dhe shëno çfarë shtyve ose çfarë tërhoqe!

VEPRIM	SHTYRJE	TËRHEQJE
	✓	

PËRSHPEJTIM, NGADALËSIM DHE NDRYSHIM I DREJTIMIT TË LËVIZJES

FORCA vepron mbi një trup të caktuar dhe mund ta ndryshojë drejtimin, ta përshpejtojë ose ngadalsojë lëvizjen.

FORCAT mund të jënë shkaku i ndryshimit të drejtimit dhe të shpejtësisë së trupave.

Nën veprimin e **FORCAVE** trupat mund të:

- Përshpejtojnë lëvizjen;
- Ngadalësojnë lëvizjen;
- Ndryshojnë drejtimin e lëvizjes.

Përgjigju se si përshpejtohet, si ngadalësohet lëvizja dhe si mund të ndryshohet drejtimi i lëvizjes së:

BIÇIKLETAVE

TOPIT

AUTOBUSIT

LOJA "KUSH ËSHTË MË I SHPEJT"

1. NEVOJITEN:

Automobila lodra.

Duke shtyrë automobila të njëjtë me forcë të ndryshme, kontrolloni cili automobil do të lëvize më shpejt. Filloni nga i njëjti vend dhe në të njëjtën kohë!

2. NEVOJITEN:

Automobila lodra, kartonë të gjatë e të hollë (një i mbështjellë me kolazh të lëmuar, një tjetër me letër të lakuar dhe i treti me shajak) dhe libra. Kontrolloni se cili automobil do të lëvizë më shpejt.

Nga shembulli i parë mund të vërtetojmë se automobili ku kemi përdorur një forcë më të madhe është më i shpejtë, kurse aty ku kemi përdorur më pak forcë është më i ngadalshëm.

Nga shembulli i dytë ne e kuptojmë se automobili nuk lëviz me të njëtën shpejtësi në sipërfaqe të ndryshme. Më shpejt lëviz në sipërfaqe të lëmuar të kolazhit, ndërsa më ngadalë në sipërfaqe të vrazhdë të shajakut.

Shtresë:: kolazh | Shtresë: letër e vrazhdë e lakuar | Shtresë:: shajak

Ngadalësimi ndodh sepse midis automobilave dhe sipërfaqes së vrazhdë ndodh fërkimi.

BURIMET E FORCAVE

MENDO DHE PËRGJIGJU:

★ Çfarë forca nevojiten për të lëvizur lodrat?
★ Si mund të përshpejtohet lëvizja e tyre dhe si mund të ngadalësohet?

Meiguri ke vërejtur që për të lëvizur lodrat nevojiten

BURIME TË NDRYSHME TË FORCËS

forca e shtytjes, tërheqjes, forca e ujit, forca ajrore, forca e mekanizmit për kurdisje, forca e motorit dhe të tjera.

MENDO DHE PËRGJIGJU?

★ Çfarë force nevojitet për të lëkundur pemën dhe gjethet?
★ Vëzhgo pemët jashtë kur ka erë! Dëgjo dhe vë re se çfarë zhurmë ka atëherë!
★ Çfarë forcë është e nevojshme për surfim?
★ A mund të mendosh për një shembull tjetër të përdorimit të forcës së erës dhe të ajrit?

★ Bëj një fruljetë me ndihmën e një të rrituri dhe hulumto, kërko më shumë mënyra të lëvizjes së saj!



j

FORCAT MAGNETIKE TËRHEQËSE DHE REFUZUESE

MAGNETI është një metal që ka vetinë të tërheqë disa metale të tjera.
Magneti tëheq disa gjësende metalike që janë afër tij dhe i tëheq kah vetja.
Forca e një magneti pë të tërhequr metale quhet
FORCA MAGNETIKE.

SHKRUAJ!

Punoni në grupe dhe kërkoni se cilin prej këtyre gjësendeve i tërheq magneti!

GJËSENDET	TËRHIQET OSE NUK TËRHIQET NGA	GJËSENDET	TËRHIQET OSE NUK TËRHIQET NGA
Gota plastike	Nuk tërhiqet	Letër	
Kapëset metalike	Tërhiqen	Stoli	
Monedha		Gërshërë	

Magnetet kanë dy pole (dy anë).

Kur afrojmë dy magnete, ato mund të tërhiqen ose shtyhen!

Kur afrohen polet e kundërt të magneteve, ato tërhiqen dhe themi se ka forcë magnetike tërheqëse

Kur afrohen polet e njëta të magneteve, ato shtyhen dhe themi se ka forcë magnetike refuzuese.

Polet magnetike janë me ngjyrë të kaltër dhe të kuqe.

RRETHO nëse tërhiqen ose shtyhen magnetet në shembuj.

Para se të përgjigjesh, provo këtë në klasë me ndihmën e dy magneteve.



Tërhiqet

shtyhet



Tërhiqet

shtyhet



Tërhiqet

shtyhet

VEPRIMI I NDRYSHËM MAGNETIK

Pavarësisht madhësisë së magneteve, ato mund të kenë **VEPRIM MAGNETIK DOBËT** ose **MËTËM FORTË.**

Bashkërisht ose në grupe provoni eksperimentet që vijojnë!

1.

NEVOJITEN: Kapëse metalike, tri gota, magnet, ujë, vaj, uthull.

Në gotën e parë vendosni ujë, në të dytën vaj, dhe në gotën e tretë uthull. Në secilin lëng vendosni disa kapëse metalike. Nga ana e jashtme afrojeni magnetin dhe kontrolloni veprimin e tij magnetik. Provoni të njëjtën gjë me magnete të ndryshme.



2.

NEVOJITEN:Disa magnete të ndryshme dhe kapëse metalike

Me magnet shumë lehtë do të tërhiqni një kapëse metalike, por për të parë se cili magnet ka veprim më të fortë magnetik, radhitni kapësет metalike si një zinxhir. Veprim më të fortë magnetik ka magneti që do të arrijë **të tërheqë zinxhir me** shumë kapëse.

TEMA

5

TINGULLI

REZULTATET E MËSIMIT

NXËNËSI/ NXËNËSJA DO TË AFTËSOHET:

TË KRAHASOJË tinguj të ndryshëm, **T'I IDENTIFIKOJË** burimet e tingullit dhe **TA SHPJEGOJË** mënyrën e krijimit të tingullit;

T'I DALLOJË burimet e tingujve muzikorë dhe të shpjegojë se si krijohen tingujt muzikorë;

TË DEMONSTROJË dhe të sqarojë **NDRYSHIME** të fuqisë së tingullit gjatë përcjelljes së tij.

TINGULLI DHE BURIMET E TINGULLIT

NJOHJA E TINGUJVE TË NDRYSHËM DHE BURIMET E TYRE

Nikolla duhet të zgjohet për në shkollë. **SHIKONI** fotografitë dhe zbuloni kush e ndihmoi të zgjohej! Si zgjohesh ti për në shkollë?

Gjithsesi, mund të konstatosh se në tri situatat e dhëna Nikolla u zgjua me ndihmën e **TINGULLIT.** Ne dëgjojmë rreth nesh **TINGUJ TË NDRYSHËM**. Tingujt janë pjesë e rëndësishme e jetës. Secili tingull ka burimin e vet. **BURIMI** është vendi ose objekti nga vjen tingulli.

AKTIVITET

★ Nxënësit ndahen në grupe. Secili grup merr një kartelë me një fotografi (Shtojca nr.11). Grupi ka për detyrë të sajojë mënyrën më të suksesshme të imitimit të tingullit që e prodhon ajo që është në kartelë. Cili është burimi i zërit të paraqitur në kartelë?

AKTIVITET

★ Ejani të gjithë së bashku të krijojmë tinguj: duartrokit me pëllëmbë, trokëllit me këmbë, kliko me gishtërinj, fishkëlle me gojë!

Shfrytëzoje Shtojcën nr. 11!

VIZATO në secilin rresht që të fitosh **BINGO!**

		
		
		
		

BURIME TË NDRYSHME TË TINGULLIT NGA MJEDISI

MENDO DHE SQARO!

★ Shiko fotografitë dhe shpjegoji burimet e zërit nga vendet e ndryshme! Krahaso!

★ Cilat vende në shkollë janë më të zhurmshme dhe cilat më të qeta? Pse?

★ Çfarë tingujsh dëgjon përgjatë rrugës nga shtëpia për në shkollë?

★ Çfarë tingujsh dëgjon kur je në natyrë?



ME ÇKA DËGJOJMË TINGUJ?

Ne tashmë mësuam për llojet e shqisave. **ME CILAT SHQISA DËGJOJMË TINGUJ ?**

AKTIVITET

★ Punë në çifte. Shiko veshët e shokut tënd! Çfarë formë kanë? Vizato me gisht, në ajër, formën e veshit të shokut tënd!

AKTIVITET

★ Mbylli sytë dhe dëgjo me vëmendje! Sa tinguj të ndryshëm do të dëgjosh? Vizato në fletore ashtu siç mendon!



GJEJ DHE RRETHO!

★ Ngjyros figurën. Gjej dhe rretho në fotografi sa më shumë që mundesh burime të tingujve!

★ Pse i zgjodhe pikërisht ato? Bisedo me shokun ose shoqen!

Veshi është shqisë për dëgjim. Njerëzit kanë dy veshë. Me ndihmën e veshëve ne dallojmë tinguj, zhurma, zëra dhe tone.

E RËNDËSISHME! Duhet të kujdesemi për shqisën e dëgjimit (veshët). Pse paraqet rrezik vendosja e gjësendeve në veshë?

LLOJET E TINGUJVE

CILET TINGUJ JANE TE KENDSHEM QE T'I DEGJOSH? NUMERO DISA PREJ TYRE!

Kantier ndërtimi



LIDH!



LËVIZJA E GJËSENDEVE KRIJON TINGULL

Në jetën e përditshme, me lëvizjen e gjësendeve krijohet tingulli.
Për shembull: duke i shfletuar faqet e librit, duke mprehur lapsin, duke e lëvizur karrigen në të cilën ulesh.

SHQYRTO DHE SQARO!

★ Cilat objekte kanë krijuar tinguj me lëvizjen e tyre në fotografitë e dhëna?

AKTIVITET

★ **Punë në grupe.** Pëpiqu të krijosh tinguj me gjësendet vijuese: shkumës, derë, letëer, sendet shkollore, gomë, kub, shpuzë!

Me lëvizjen e gjësendeve krijohet tingulli.

Prej nga vjen tingulli i zërit tënd?

Të provojmë të flasim dhe të këndojmë, ndërsa në të njëtën kohë lehtë e prekim pjesën e përparme të fytit. A mund ta ndiejmë lëvizjen, përkatësisht dridhjet?

Prej nga vjen tingulli (zhurma) nga drunjtë? Vështroni drunjtë kur ka erë!

Përgjigju në pyetjet vijuese:

★ A dëgjojmë tingull (zhurmë) përderisa gjethet lëkunden?

★ Kush e shkakton lëkundjen e gjetheve?

TINGUJT MUZIKOR

TINGUJ NGA INSTRUMENTET E NDRYSHME MUZIKORE

AKTIVITET

★ Përpunimi i instrumenteve muzikore prej materialeve të ndryshme.



Bëje një instrument muzikor me tela prej një! kutie kartoni!

MATERIALET ENEVOJSHME: kuti këpucësh dhe pesë llastikë .Llastikët vendosi si në fotografi!



Përgatit një instrument muzikor nga një kanaçe, siç tregohet në fotografi!

MATERIALET ENEVOJSHME: kanaçe metalike, tullumbace dhe dy lapsa me gomë.Përgatit një instrument muzikor me gypa plastike, siç është dhënë në fotografi!

Bëni një instrument frymor muzikor nga tuba plastikë, siç tregohet në foto!

MATERIALET E NEVOJSHME: gypa, shirit ngjitës dhe gërshëre.

Instrumentet muzikore ndahen në: instrumente me tela, me goditje dhe frymore.Ato mund të prodhojnë tingull dhe ton.

AKTIVITET

★ Krijo tinguj me instrumentet e bëra muzikore!

★ Zbulo mënyrën se si ato krijojnë tinguj!

★ Krahaso burimet e tingujve!

★ Çka konstatove?

PRIT DHE NGJIT fotografitë sipas shembujve të dhënë!





Shfrytëzoje Shtojcën nr.12!

SI KRIJOJNË TINGULL INSTRUMENTET MUZIKORE?

Veglat muzikore krijojnë tone. Të gjiths instrumentet krijojnë ton (tingull) të ndryshëm

Tingulli nga burimi i tij përhapet në të gjitha kahjet.

Tingulli i daulles fitohet kur me shkopinjtë godet membrana e instrumentit, me anë të së cilës ajo dridhet dhe fitohet **TON** (dëgjojmë **TINGULL**).

Toni i kitarave është krijuar duke dridhur tela. Telat fillojnë të dridhen kur pak/ shkurt do t'i shtypim ato me gishtat e dorës. Atëherë e dëgjojmë **TINGULLIN**



Tingulli fitohet me goditjen e dy shkopinjve në pllakat prej metali në metalofon. Prodhohet ton i qetë, I **SHKURTËR** dhe **DRIDHËS**.

TONI i fyellit fitohet me fryrje dhe me dridhje të ajrit në gypin e instrumentit.

AKTIVITET

★ Demonstroni lloje të ndryshme të tingujve që mund t'i krijoni!

★ Provoni të krijoni tinguj në mënyra të ndryshme me përdorim të instrumentve muzikore për fëmijë

SHQYRTO DHE SQARO!

★ Cilat lëvizje e shkaktojnë tingullin?

BURIMET E TINGULLIT

Sa më afër burimit të tingullit jemi aq mirë do të dëgjojmë.

AKTIVITET

★ Mësuesi i demonstron efektet që shkakton tingulli (duke goditur daullen në të cilën vendosen kokrra orizi, duke e vendosur altoparalant në të cilin dëgjohet .muzikë një fletë letre me kripë ose sheqer)

Përgjigju në pyetjet vijuese:

Çfarë ndodh me orizin dhe kripën? Pse?

AKTIVITET

★ Shëtituni përreth oborrit të shkollës dhe njihuni me tingujt e ndryshëm nga mjedsi!

Tingullin nuk mund ta shohim, por mund të vërejmë dhe të shikojmë cilat efekte krijohe prej tingullit.

VIZATO!

Pas shëtitjes jashtë shënoni tingujt që i dëgjuat!

EKSPERIMENT SHTESË

Muzika e erës



Materiali i nevojshëm: katër lugë, një, rreth i vogël dhe pe. Lidhni lugët me pe!

Skajin tjetër të perit lidheni për harkun!Në fund lidheni edhe një pe në rreth, nga njëra dhe nga ana tjetërdhe vendoseni jashtë në një dru!

Pastaj prisni që të fryjë era dhe kënaquni me muzikën e krijuar!

EKSPERIMENT SHTESË

Vendos altoparlant në një gotë! Mbulo gotën më një qese ose fletë plastike! Vendos grimca në të! Vëre se çfarë ndodh me grimcat përderisa altoparlanti punon! Çfarë ndodh kur tingulli është më i lartë, më i zëshëm?

- ★ Si e krijojnë bulkthat tingullin? (Ato fërkojnë këmbët e pasme.)
- ★ Si dëpërton, përhapet zëri?
- ★ A përhapet shpejt ose ngadalë?

PËRCJELLJA TINGULLIT

TINGULLI PËRHAPET



CILAT JANË SHQISATE E DËGJIMIT?

VESHI ËSHTË NJE ORGAN SHQISOR QË PRANON TINGULLIN.

TINGULLI KRIJOHET NËPËRMJET DRIDHJEVE (VIBRIMEVE).

Çdoherë kur një objekt dridhet (vibron) shkakton lëvizje si valët.
Kjo është e ngjashme me valët në ujë.

TINGULLI NGA PUSI

Materiali i nevojshëm: **kovë dhe shishe plastike**

Mbushni një kovë deri në gjysmë me ujë! Në kovën me ujë futni një shishe plastike me vrimën lart! Vër veshin në vrimën e shishes dhe dëgjo tinqujt e ujit!

LOJË „TELEFONI I PRISHUR"

Ne dëgjojmë kur tingulli shpërndahet nga burimi i tij dhe depërton në veshin tonë. Luaj lojën Telefoni i prishur! Dëgjoni me vëmendje dhe përpiquni të përcillni fjalën e duhur njëri pas tjetit deri te nxënësi i fundit!

SECILI TINGULL KA BURMIN E VET.

Burimi është vendi ose bjekti prej ku vjen, buron tingulli. Ai depërton deri në veshët tanë.

FORCA E TINGULLIT

Duke u larguar nga burimi i tingullit, ai bëhet më i gëtë, më i dobët idhe i paqartë.

Sa më afër burimit të tingullit jemi aq më qartë e më shumë e dëgjojmë tingullin.

★ Rikujtohu në ndonjë situatë kur nuk ke dëgjuar atë që po fliste ndonjë nxënës?

★ Çfarë mendon, pse?



Me siguri u kujtove se shokun nuk e ke dëgjuar qartë, meqë ka qenë më larg teje.
Sa më larg prej nesh është burimi i tingullit aq më dobët e dëgjojmë tingullin.

AKTIVITET

Një nxënëës le ta këndojë këngën e tij të preferuar. Disa nxënës le të shpërndahen në largësi të ndryshme nga ai! Vëreni se sa qartë e dëgjojnë këngën! Ndryshoni rolet dhe secili të këndojë këngë të ndryshme!

EKSPERIMENTE SHTESË PËR TINGULLIN

BËJ INSTRUMENTE MUZIKORE PËR FËMIJË!

TROKITËSE. Gota plastike (ose kavanoza) mbushi me fasule ose oriz!
Sipër vendos letër pjekjeje dhe mbylli me llastik, ndërkaq kavanozin mbylle me kapak! Krijo tinguj me lëvizjen e kavanozit!

TROKITËSE

Mbush me thjerrëza një tullumbace! Fryj tullumbacen dhe lidhe!
Hidhe dhe krijo tinguj!

INSTRUMENT ME TELA

Në kapakun e kavanozit vendos katër deri në pesë llastikë. Përmbi ngjit shkop druri! Krijo tinguj me tëhegjen e llastikave!



HARMONIKË E GOJËS Merr dy shkopinj druri! Vendos një shirit të hollë letre midis tyre dhe në skajet nga një gjysmë dhëmbëkruajtëse! Me ndihmën e llastikave lidh dy skajet e instrumenteve! Krijoni tinguj duke fryrë në të!



Një nxënës krijn tinguj në klasë në ndonjërin prej instrumenteve të bëra. Nxënësi tjetër e dëgjon tingullin e njëjtë në klasë, e më pas para dere.

PËRGJIGJU :

- Ku është tingulli më i dobët?
- Ku është i paqartë?
- Pse?

★ Tingulli bëhet më i qetë në qoftë se ka pengesë ndërmjet burimit dhe shqisës së dëgjimi.

SHTOJCAT



SHTOJCA NR. 1 PËR NJË MËSUES

Mësuesi/ja lexon përshkrimet dhe nxënësit duhet të qëllojnë se ku do të ngjitin figurat përkatëse.

Unë kam flokë kaçurrela të zeza, sy kafe, syze dhe një bluzë të kuqe.	Unë kam flokë të shkurtër të hapur, sy blu, lëkurë të hapur, kam syze dhe një fustan të zi.
Unë kam flokë të gjatë kafe, sy të gjelbër, lëkurë të errët dhe kam veshur pantallona blu.	Unë kam flokë të kuq, sy të zinj dhe vesh një bluzë jeshile.

SHTOJCA NR. 1

NJERIU DHE TRUPI I NJERIUT

SHTOJCA NR. 2

ÇFARË KA NË PJATËN TIME?



SHTOJCA NR. 3





SHTOJCA NR. 4

LIBRI I VËZHGIMIT

NGA _____





SHTOJCA NR. 5
















SHTOJCA NR. 6



SHTOJCA NR. 7

SHTOJCA NR. 8



SHTOJCA NR. 9



SHTOJCA NR. 10











SHTOJCA NR. 11



SHTOJCA NR. 12

NJOHJA E TINGUJVE TË NDRYSHËM DHE BURIMET E TYRE









SHTOJCA NR. 13

TINGUJT E INSTRUMENTEVE TË NDRYSHME MUZIKORE